



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:286661
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06229259

Pml.nr.561/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E. B., për shkak të veprave penale: ndërtimi pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe heqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 406 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.7/2022 të datës 02.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.47/2024 të datës 20.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit E. B. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.7/2022 të datës 02.10.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.47/2024 të datës 20.03.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.7/2022 e datës 02.10.2023, të dënuarin E. B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale ndërtimi pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me kusht, ashtu që i ka caktuar dënim burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse për veprën penale heqja apo dëmtimi i vulave ose shenjave nga neni 406 të KPRK-së i ka shqiptuar dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj duke i shqiptuar dënim unik me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda periudhës prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale. I dënuari është obliguar në pagesën prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 20 €, në fondin e kompensimit të viktimave të krimit. Është urdhëruar rrënimi i objektit të ndërtuar pa leje me shpenzime të të dënuarit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.47/2024 e datës 20.03.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër aktgjykimeve të kundërshtuara kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit E. B., avokati Granit Vokshi nga P., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimin e kundërshtuar.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.327/2024 e datës 17.09.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje të dispozitës ligjore të nenit 404 par.1 të KPP-së, meqë nuk ka shqyrtuar dhe argumentuar

pretendimet e ngritura duke mos dhënë arsytim se a qëndrojnë apo nuk qëndrojnë pretendimet e tilla. Për më tepër, gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar faktin se gjendja faktike nuk ka qenë objekt i shqyrtimit, meqë i dënuari gjatë shqyrtimit fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë për veprat penale dhe i cili pranim ishte bërë në mënyrë vullnetare, pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe pranimi i fajësisë kishte mbështetje në provat që përmbante aktakuza. Por, gjykata e shkallës së parë me rastin e pranimit të fajësisë nuk ka pasur parasysh faktin se aktakuza përmbante shkelje ligjore dhe gabime faktike, kjo për faktin se vepra penale e supozuar në kohën e fillimit të ndërtimit në vitin 2018 nuk ishte paraparë se ndërtimi pa leje paraqiste vepër penale.

Pretendohet se aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë bazohet në Kodin Penal të Kosovës - Kodi nr.06/L-074 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019, kurse ndërtimi i objektit kishte filluar në vitin 2018 e i cili fakt do të duhej të merrej parasysh nga dy instancat gjyqësore, pasi që objekti ishte në fazën e ndërtimit të vrazhdë e që në vitin 2018 ishte në fuqi Kodi nr.04/L-082 dhe i cili Kod nuk kishte paraparë ndërtimin pa leje si vepër penale. Kjo për faktin se edhe sipas dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë theksohet se “më parë e gjer me datë 15.12.2021...” dhe se fjalia më parë kishte ndodhur gjatë vitit 2018, pra në kohën kur kjo vepër penale nuk ishte paraparë si vepër penale.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka bërë vlerësimin e të gjitha rrethanave me rastin e përcaktimit përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, përkatësisht nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese e posaçërisht faktin se i dënuari për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilëve është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar. Është e rëndësishme të potencohet fakti se nga shkresat e lëndës, përkatësisht procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 02.10.2023, del se i dënuari në mënyrë vullnetare dhe në prezencë të mbrojtësit të tij kishte bërë pranimin e fajësisë dhe i cili pranim është konstatuar se ishte në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 242 par.1 të KPPK-së. Për më tepër, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimet e kundërshtuara janë përpiluar në dritën e pranimi të fajësisë dhe kjo del të jetë arsyeja që gjykata e shkallës së dytë në këtë frymë kishte shqyrtuar pretendimet ankimore vetëm përkitazi me bazat që janë të lejuara në rastet e pranimi të fajësisë.

Megjithatë pretendimi se vepra penale për të cilën i dënuari ishte gjykuar nuk ishte kryer në kohën kur ishte inkriminuar duke u bazuar në dispozitat Kodit Penal të Kosovës - Kodi nr.06/L-074 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2019, meqë punimet në objektin ndërtimor kishin filluar në vitin 2018, gjegjësisht kur ishte në fuqi Kodi Penal i Kosovës - Kodi nr.04/L-082 dhe se kjo vepër penale nuk inkriminohej si vepër penale, del të jetë pretendim i pabazuar dhe kjo duke u bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht procesverbalin e marrjes në pyetje të të pandehurit të datës 09.11.2021, me ç’rast i njëjti deklaroi se: “Ndërtimin e kishte filluar gjatë vitit 2020 ndërsa në këtë vit e kam përfunduar” e që sipas deklaramit të tij objekti ishte përfunduar në vitin 2021 e që mbi këtë bazë del se i njëjti kishte bërë pranimin e fajësisë dhe ishte shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i ashpër dhe me këtë rast është bërë shkelja e ligjit penal, pasi që nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese të cilat po të vlerësoheshin në mënyrë të duhur të dënuarit do të i shqiptohej dënim më i butë. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së dytë në faqen e katërt dhe të pestë të aktgjykimimit

të saj ka dhënë arsyetim të hollësishëm për të gjitha rrethanat, andaj, nga kjo del se arsyetimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë e aprovon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.561/2021, më 25 shtator 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala